REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:171981
Datë: 02.11.2021
Numri i dokumentit: 02348745

Ac.nr.8259/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Enes Mehmeti - kryetar i kolegjit, Lumni Sallauka dhe Arsim Hamzaj , anëtarë të kolegjit, në çështjen kontestimore të paditësit B.L nga ..., komuna Skenderaj të cilin me autorizim e përfaqëson av .H.S. nga Prishtina kundër të paditurës Ndërmarrja "Iber Lepenc" SH.A, Sheshi "Bill Klinton" nr. 13 Prishtinë të cilin sipas autorizimit e përfaqëson , Nexhmije Sadiku juriste , duke vendosur lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurimit , duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.5908/21,(2021:171981) datë 17.09.2021, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datën 28.10.2021, ka marr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar , ankesa e të paditësit B.L nga Skenderaj, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.5908/21 (2021:171981) datë 17.09.2021 **VËRTETOHET.**

A r s y e t i m i

Gjykatës Themelore në Prishtinë , me aktgjykimin e ankimuar ka vendosur si vijon:

" REFUZOHET i pa bazuar propozimi i paditësit –propozuesit , B.L Nga ...,, Komuna Skenderaj, me të cilin ka kërkuar që i padituri –kundërshtarit i propozimit , Ndërmarrja Hidorekonomike " Iber Lepenci" SH.A. , Sheshi Bill Kllinton , nr. 13, Prishtinë. të pezulloj Vendimin nr.08-1529 të datës 21.07.2021, deri në përfundimin e procesit gjyqësor . si dhe të urdhërohet kundërshtari i propozimit Ndërmarrja Hidorekonomike " Ibër Lepenci" SH.A, Sheshi " Bill Klinoton", nr.13 Prishtinë , që të ndermarrë te gjitha masatë nevojshme për kthimin e propozuesit në pozitën e Kryeshefit Egzekutiv N.H " Iber Lepnec" SH.A, dhe që i njëjti të vazhdoj punën ,e të gjitha të drejtat dhe obligimet sipas kontratës së punës me nr.01-319, të datës 13.12.2019, deri në përfundimin e procesit gjyqësor ."

Kundër këtij Aktvendimi paditësi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit gabuar dhe jo të plotë të gjendjen faktike dhe vërtetimit jo të plotë apo të gabuar të gjendjes faktike, me propozim gjykata

2021:234731

e Apelit t`a aprovoj ankesën dhe Aktvendimi i atakuar të prishet dhe lëndën t`ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe vendosje.

Përgjigje në ankesë kanë paraqitur të paditurit, përmes së cilave i kanë propozuar gjykatës që ankesa e paditësit të refuzohet si e pabazë ndërsa Aktvendimi i atakuar të mbetet në fuqi.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi kundër të paduarës ka ushtruar padi për anulimin e vendimit për shkëputjen e marrëdhënies së punës, dhe së bashku me padinë ka ushtruar edhe propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, me objekt mase, pezullimin e vendimit për largim nga puna dhe kthimin e paditësit në detyrat e mëparshme të punës, si kryeshef ekzekutiv, i të paduarës.

Paditësi me propozim për caktimin e masës së sigurimit pretendon se ekzistojnë si të përmbushura kushtet ligjore nga neni 297 parg.1 pika a) dhe b) e LPK-së, për caktimin e masës së përkohshme ndaj të paduarës, për faktin se kundërligjshmëria e vendimit të Bordit të të paduarës për largimin e tij nga puna është evidente duke qenë se e paditura me rastin e shkëputjes së kontratës së punës paditësit, ka cenuar ligjshmërinë dhe kështu ka privuar të paduarin nga të drejtat e tija nga marrëdhënia e punës, kundërligjshëm, ndaj dhe vendimi i te paduarës nr.08-1529 date 21.07.2021 duhet shpallur si joligjor.

Gjykata e shkallës së parë, ka refuzuar propozimin e paditësit si të pa bazuar me arsyetimin se propozimi nuk ka plotësuar asnjërin nga kushtet ligjore nga neni 297 parg.1 pika a) dhe b) e LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që Aktvendimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe as në shkelje të dispozitave të ligjit material për të cilat shkelje Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, dhe se Aktvendimi është nxjerr me vërtetim të drjetë dhe të plotë të gjendjes faktike.

Gjykata e Apelit e ka pranuar si të ligjshëm përfundimin e gjykatës së shkallës së parë me arsyet e dhëna se paditësi nuk ka arritur të plotësoj kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 297 parg.1 nënparg. a) dhe b) e LPK-së, për bazueshmërinë e propozimit për masë të sigurimit, ngase pas vlerësimit të gjendjes së fakteve dhe provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, rezulton probabiliteti i ultë përkitazi me pretendimin e paditësit, për ekzistimin e të drejtës së tij subjektive, sigurimin e te cila e kërkon përmes caktimit te masës se sigurimit, dhe në rastin e tillë kur gjasat për ekzistimin e së drejtës subjektive të palës mbi objektin e masës janë vlerësuar me probabilitet të ultë, nënkuptueshëm rezulton edhe situata se nuk mund të ekzistoj rreziku i cili do t`a pamundësonte apo vështirësonte realizimin e ndonjë të drejtë subjektive të palës paditëse, ndaj duke qenë se propozimi i paditësit nuk përmbush kushtet ligjore nga neni 297 parg.1 nënparg. (a) dhe (b) të LPK-së, gjykata e Apelit e ka vlerësuar si të drejtë Aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, duke e lënë në fuqi të njejtin si të ligjshëm.

Kolegji veçanërisht vlerësoi natyrën e objektit të masës së sigurimit e cila është e ngjashme me kërkesëpadinë e paditësit, dhe nën situatën e tillë kur zgjidhja sipas propozimit për masë është paragjykuese apo e njëjta e zgjidh vet/teresisht çështjen kontestuese duke qenë

2021:234731

se objekti i saj është i ngjashëm me objektin e padisë atëherë nën kushtet e përcaktimeve ligjore nga nei 300 parg.3 i LPK-së rezulton situatë e atillë e cila nuk lejon caktimin e masës së sigurimit, si në rastin konkret, ndaj dhe krahas arsyeve të dhëna më lartë edhe si edhe për këtë rrethane, është dashur që propozimi i paditësit për caktimin e masës së sigurimit të refuzohej si e pabazë.

Nga sa u tha më sipër, Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 pika (b) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.8259/21 me datë 28.10.2021

Kryetari i kolegjit-gjyqtari,
Enes Mehmeti